


AL

Udhëzime për përdorim




Ngrirësi vertikal

*Ju falënderohemi për mirëbesimin tuaj që keni treguar me rastin e blerjes së aparatit tonë.
Ju dëshirojmë shumë kënaqësi tek përdorimi.*

Arka ngrirëse është e dedikuar për përdorim në amvisëri për ngrirjen e artikujve ushqimorë të freskët dhe për ruajtjen afatgjate të artikujve ushqimorë të ngrirë (deri në një vit, varësisht nga artikulli ushqimor).

Vërejtje të rëndësishme	3
Këshilla për kursimin e energjisë elektrike te aparartet për ftohje dhe ngrirje.....	4
Përshkrimi i aparatit.....	5
Vendosja dhe aderimi.....	7
Ndryshimi i drejtimit të hapjes së derës.....	9
Komandimi i aparatit.....	12
Ngrirja dhe ruajtja e artikujve ushqimorë.....	16
Shkrirja e aparatit	19
Pastrimi i aparatit	20
Evitimi i pengesave	21
Informatat për zhurmën e aparatit	23



- Aparati është i prodhuar në ujdi me standardet mbrojtëse të parapara me rregulla, megjithatë, nuk ju rekomandojmë që pa mbikqyrje të nevojshme t'a përdorin personat me kapacitete të dobësuara fizike, lëvizëse ose mentale, resp. personat me mangësinë e përvojës ose të diturisë.
- Para kyçjes së aparatit, nevojitet që me saktësi të lexoni udhëzimet për përdorim, të cilat përshkruajnë aparatin dhe përdorimin e tij të rregullt dhe të sigurtë. Ata janë të adaptuara tipeve/modeleve të ndryshme të aparateve, prandaj, është e mundëshme që të jenë të përshkruara edhe rregullimet dhe pajimet të cilat nuk i përban aparati i juaj. Udhëzimet kyçin edhe realizimin e ngrirësit NO FROST, për të cilin janë karakteristike ventilatori i instaluar dhe shkrirja automatike.
- Evitoheni ambalazhin e dedikuar për mbrojtjen e aparatit resp. pjesëve të posaçme në ndërkohë të transportimit.
- Në skajet e derëve janë të montuar distancuesit, ata i evitoni, kurse në vendin e tyre i vendoni tapotë e bashkangjitura (i përbajnë vetëm disa modele).
- Para aderimit të aparatit në rrjetën elektrike, aparati le të qëndrojë në pozicion vertikal përafërsisht 2 orë. Kështu zvogëloni mundësinë e funksionimit jo të rregullt për shkak të ndikimit të transportit në sistemin e ftohjes.
- Kyçja në rrjetën elektrike dhe tokëzimi i aparatit nevojitet të realizohet në bazë të standardeve dhe rregullave në fuqi.
- Nuk lejohet përdorimi i aparatit në natyrë dhe se nuk lejohet të jetë nën ndikimin e të rreshurave.
- Para pastrimit dhe këmbimit të llambës, patjetër shkyçni aparatin nga rrjeta elektrike (nxjerrni kablone kyçëse nga priza).
- Nëqoftëse kabloja kyçëse është e dëmtuar, le të këmbëjë atë serviseri ose personi i aftësuar nga profesioni.
- Nëqoftëse aparatin nuk do të përdorni gjat kohë, atë e shkyçni me pullë dhe ndërpreni furnizimin me energji elektrike. Zbrazni aparatin, shkrini, pastroni dhe lejeni derën gjysëm të hapur.
- Për shkak të kujdesit ndaj rrethit, aparatin e harxhuar dorëzoni tubuesve të autorizuar të aparateve të harxhuara.
- Për ambalazhim përdorim materiale të pranueshme për rrethin, të cilët, pa rrezik për rrethin mund të përpunohen përsëri, deponohen ose të zhduken.
- Le të mos lozin fëmija me aparatin.
- Etiketa me të dhënat elementare të aparatit gjendet në brendësi të aparatit. Nëqoftëse ajo është në gjuhën që juve nuk ju pëlqen, këmbëjeni me atë të bashkangjiturën.
- **Kujdes!** Hapësirat (vrimat) për ajrosje në aparat, resp. në elementin instalues nevojitet të jenë gjithmonë të pastërta dhe të zbraza.

- **Kujdes!** Mos përdorni tek shkrirja gjësede mekanike ose metoda tjera, përveç atyre që i rekomandon prodhuesi.
- **Kujdes!** Tek vendosja, pastrimi dhe evitimi i aparatit jeni të kujdesshëm që të mos dëmtoni izolimin resp. pjesët e sistemit për ftohje. Me këte parandaloni edhe ndotjen e ambientit.
- **Kujdes!** Mos përdorni mbaresat elektrike në brendësi të aparatit, përveç atyre të cilat i lejon prodhuesi i aparatit për ftohje dhe ngrirje.

Ky aparat përmban shënjen e aparaturave elektrike dhe elektroteknike sipas Udhëzimit 2002/96/EG (waste electrical and electronic equipment - WEEE).


Udhëzimi jep kuadrin ligjor për te drejtën e kthimit mbrapsht të aparaturave të përdorura në të gjithë BE.

Këshilla për kursimin e energjisë elektrike te aparatet për ftohje dhe ngrirje


- Aparatin e poziciononi siç është përshkruar në udhëzime.
- Mos hapni derën e aparatit më shpesh se sa është e nevojshme.
- Kohë pas kohe kontrolloni që qarkullimi i ajrit pas aparatit të jetë i papengueshëm.
- Kondensatori në murin e pasme të aparatit gjithmonë nevojitet të jetë i pastër (shiqo kapitullin Pastrimi i aparatit).
- Guarnicionin e dëmtuar ose joputhitës sa më parë ndërrojeni.
- Artikujt ushqimorë rruani në enët e mbyllura ose të ambalazhuara.
- Para se të konservohen, artikujt ushqimorë të ftohen në temperaturën e dhomës.
- Artikujt ushqimorë të ngrirë nevojitet të shkrihen në hapësirën e ftohjes.
- Evitoni sirtarët dhe derëzat në ngrirës siç është përshkruar në udhëzime, që të shfrytëzoni tërë vëllimin.
- Ngrirësin klasik e shkruani pasi që në sipërfaqet e ftohura tubohet përafërsisht 3-5 mm ngricë, resp. akull.
- Rradhitja e rafteve nëpër hapësirë le të jetë e njëtrajtëshme, kurse artikujt ushqimorë të rradhitur ashtu që të sigurohet qarkullimi i papengueshëm i ajrit (merrni në përfillje rradhitjen e rekomanduar të artikujve ushqimorë siç është e përshkruar në udhëzime).
- Te aparatet me ventilator mos i mbulonit vanat e ventilatorit.

Përshkrimi i aparatit

NGRIRËSI KLASIK



- 1 Njësia komanduese
- 2 Llambëza për ndriçimin e brendësisë*
- 3 Hapësira për ngrirje
- 4 Hapësira për ngrirjen e shpejtë të artikujve ushqimorë të vegjël*
- 5 Hapësira e madhe për ruajtje - sirtari SpaceBox*




- 6 Hapësira për ruajtje
- 7 Olluku për shkarkimin e ujit të shkrirë
- 8 Bartësi i këmbëzës*
- 9 Këmbëza
- 10 Rrotëza*
- 11 Akumulatori i akullit*

- Pajisja e brendëshme e aparatit mund të ndryshojë sipas modelit të aparatit.
- Sirtarët janë të mbrojtur nga dalja. Nëqoftëse dëshironi që ate t'a nxjerrni nga aparati, të hapur e çoni lartas në pjesën e mesit dhe e nxjerrni. Disa nga modelet përbajnë udhëzues që tërhiqen, të cilët, lehtësojnë tërheqjen e syzëjeve. Syzën, (gjegjesisht raftin) në udhëzuesit nxjerrës e nxjerrni ashtu, që ate në pjesën e fundit e çoni dhe e tërheqni nën këndin prej 45°. Përsëri e vendoni në rradhitjen e kundërt.

* E përbajnë vetëm disa modele.

NGRIRËSI NO FROST



- 1 Njësia komanduese
- 2 Llambëza për ndriçimin e brendësisë*
- 3 Njësia për ngrirje NO FROST (agregati për ftohje, ventilatori...)*
- 4 Hapësira për ngrirje dhe ruajtje
- 5 Hapësira e madhe për ruajtje - sirtari SpaceBox*
- 6 Bartësi i këmbëzës*
- 7 Këmbëza
- 8 Rrotëza*

- Notranja oprema aparata se lahko spreminja glede na model aparata.
- Predali so varovani proti izvleku. Če ga želite vzeti iz aparata, ga odprtega privzdignite v sprednjem delu in izvlecite.
Nekateri modeli imajo izvlečna vodila, ki olajšajo izvlek predalov.
Predal na izvlečnih vodilih snemite tako, da ga v zadnjem delu privzdignete in izvlecite pod kotom 45°. Vstavite v obratnem vrstnem redu.
- Ventilator (skrit v zamrzovalni enoti) prispeva k bolj enakomerni razporeditvi temperatur. Ne deluje, ko so vrata zamrzovalnika odprta in v času mirovanja kompresorja.

* Imajo samo nekateri modeli.

Vendosja dhe aderimi


Zgjedhja e ambientit

- Aparatin e vendoni në hapësirë të thatë dhe të ajrosur. Me rregullsi funksionon tek temperaturat e rrethit, e këta janë të parashtruara në tabelë. Klasa është e cekur në etiketën me të dhënat elementare për aparatin.


Klasa	Temperatura
SN (subnormale)	prej +10°C deri në +32°C
N (normale)	prej +16°C deri në +32°C
ST (subtropike)	prej +16°C deri në +38°C
T (tropike)	prej +16°C deri në +43°C

Vendosja e aparatit

Tek vendosja e aparatit le të bashkëpunojnë së paku dy persona, që të parandalohen dëmtimet e aparatit ose lëndimet e njerëzve.



- Aparati nevojitet të qëndrojë rrafshç dhe stabil në dysheme të fortë. Në anën e parë të aparatit gjenden këmbëzat rregulluese, me të cilat e barazpeshoni aparatin. Në anën e prapme gjenden rrotëzat, të cilat mundësojnë pozicionimin e lehtë të aparatit (i kanë vetëm disa modele).
- Elementi mbi aparat nevojitet të jetë i venduar mbi aparat së paku 5 cm, kjo mundëson ftohje të mjaftueshme të kondensatorit.
- Mos vendoni aparatin nën ndikimin direkt të rrezeve të diellit dhe se mos e vendoni në afërsi të burimeve të ngrohjes. Nëqoftëse kësaj nuk mund t'i largoheni, instaloni pllakë izoluese.
- Në anën e parë, në nënshtresën e aparatit gjenden dorëzat për lëvizje më të lehtë (i kanë vetëm disa modele). Aparati mund të vetqëndrojë ose e vendoni krahas me elementin mobiljar ose murinë. Merrni në konsiderim vendin e lirë për hapjen e derës tek tërheqja e sirtarve dhe rafteve (shiqoni skicën e vendosjes).



Kujdes: te pozicionimi i aparateve ashtu që të qëndrojnë njëri pranë tjetrit (side by side) nevojitet të blehet dhe instalohet kompleti i servisit kundër vesimit!

Kodi për porositjen e kompletit: 151046


Kyçja e aparatit


- Aparatin e kyçni në rrjetën elektrike me kablo kyçëse. Priza në muri nevojitet të jetë e pajisur me kontakt tokëzues (priza mbrojtëse). Tensioni i paraparë elementar dhe frekuenca janë të cekura në etiketën me të dhënat elementare të aparatit.
- Kyçja në rrjetën elektrike dhe tokëzimi i aparatit nevojitet të jetë i realizuar sipas standardeve dhe rregullave në fuqi. Aparati reziston oscilime afatshkurte të tensionit elementar, por më së shumti prej -6% deri në +6%.

Ndryshimi i drejtimit të hapjes së derës

Veglat e nevojshme: çelësi nr. 8, kaçavidha, torx 25, kaçavidha e rrafshë

1. Me ndihmën e kaçavidhës së rrafshë evitoni kapakëzat A dhe B1.
2. Rradhazi prej naltas poshtë zhvidhoni – evitoni menteshenë (C), derën (D) dhe menteshenë (E1). Kujdeseni që të mos dëmtohet dera.
3. Tapotë mbuluese (H) transferojeni në anën e kundërt.





4. **REALIZIMI I: Dera (D):** në anën e kundërt transferojeni kushinetën (J). Evitoheni kufizuesin e hapjes së derës (K1) me kushinetën (L), kurse në anën e kundërt përforcojeni ate simetrik (K2), i cili bashkërisht me kushinetën (L) është i bashkangjitur në qeskë.



REALIZIMI II: Dera (D): zhvidhoni kapakun e derës (M) dhe evitoheni bashkërisht me mbuluesen (N). Kushinetën (J) transferojeni në anën e kundërt të derës. Mbuluesen (N) rrotullojeni për 180° dhe transferojeni në anën e kundërt të kapakut (M), kurse kapakun vidhoni përsëri në vend të vet. Evitoheni kufizuesin e hapjes së derës (K1) me kushinetën (L), kurse në anën e kundërt përforcojeni ate simetrik (K2), i cili është bashkërisht me kushinetën (L) i bashkangjitur në qeskë.

5. Rradhazi prej poshtë naltas: vendojeni menteshenë e poshtme (E2), e cila është e bashkangjitur në qeskë, vendojeni derën (D) dhe përforcojeni menteshenë C. Mos harroni të instaloni rondelat siç kan qenë para demontimit.
6. Vendojeni kapakëzat A dhe B2 (kapakëzën B2 nga qeska).
7. **Ndërrimi i dorëzës:** evitoni kapakëzat, Zhvidhoni vidhat dhe përforconi dorëzën në anën e kundërt. Vendojeni kapakëzat në anën e kundërt. Në vendin ku ka qenë e vidhuar dorëza, vendoni mbulueset e bashkangjitura në qeskë.

Elementet B1,E1 idhe K1 ruani për ndryshimin e sërishëm eventual të drejtimit të hapjes së derës.

* Kufizuesit K1, K2 i kanë vetëm disa modele.

Pas zhvidhimit ose vidhimit të mentesheve nevojitet të mbahet dera,që të mos bijë dhe të dëmtohet.




1. Evitoheni kapakun e menteshesë së sipërme të derës (kapakun e ruani për ndërimin eventuel të mëvonshëm të derës). Evitoheni edhe kapakun në anën e kundërt të kapakut të menteshesë së sipërme (në anën e kundërt do të vendoni ate të bashkangjiturin në rast të procesit të montimit) dhe evitoheni kapakun në anën e kundërt të anës së sipërme të derës.
2. Zhvidhoni dy vidhat e menteshesë së sipërme, nxjerrni derën nga mentesheja e poshtme.
3. Në anën e poshtme të derës zhvidhoni dy vidhat me të cilët është i përforcuar kufizuesi i hapjes së derës dhe evitoheni (A). Kufizuesin nevojitet të ruani për ndërimin e përsërishtëm eventuel të derës, në anën e poshtme të derës përforcojeni kufizuesin me kushinetë të bashkangjitur për derën.
4. Zhvidhoheni sistemin për mbylljen e dhunshme të derës (B) dhe vidhoheni në anën e kundërt të derës (e përbajnë vetëm disa modele).
5. Mënjaroni aparatën prapas (max. 35°) ashtu, që prapas të mbështetet në shtëpizë. Zhvidhoni vidhat me të cilat janë të përforcuar bartësit e këmbëzëve (C) – të majtën dhe të djathtin, në bartësin e këmbëzës evitoheni kapakun mbulues (D) dhe transferojeni në të kundërtin. Zhvidhoni, gjegjësisht evitoni dhe ndëroni ndërmjet vendosjen e çepit kthyes (E) dhe çepit mbulues (F). Zhvidhoni tre vidhat me të cilët është e përforcuar mentesheja e poshtme (menteshenë ruani për ndërimin e përsërishtëm eventuel të derës), kurse në anën e kundërt përforcojeni menteshenë e poshtme të bashkangjitur.
6. Procesin e montimit e vazhdoni në radhitjen e kundërt.


Vërejtje: Te aparatet me dorëzën horizontale nëpër tërë lartësinë e derës, ndërimi i derës nuk është i mundshëm.

Komandimi i aparatit

NJËSIA KOMANDUESE I



NJËSIA KOMANDUESE II



A Pulla për rregullimin e temperaturës dhe kyçje/shkyçje të aparatit

B Llambëza: ndriçon kur funksionon aparati

C Tasti shkyçje e alarmit zanor të ngrirësit

D Llambëza: rreh te alarmi i ngrirësit

E Tasti ngrirja intensive


F Llambëza: ndriçon kur funksionon rregullimi Ngrirja intensive

G Indikator digjital i temperaturës së ngrirësit tregon temperaturën faktike në aparat prej -16°C deri në -24°C*

* E kanë vetëm disa modele.


No Frost mbishkrimi – e kanë vetëm disa modele.

Kyçja/shkyçja e aparatit




A

Aparatin e kyçni ashtu, që pullën **A** e rrotulloni në drejtim të **max**. Llambëza **B** ndriçon. Aparatin e shkyçni kur pozicioni i thellimit në pullë është te shenja  (aparati është akoma nën tensionin elektrik).



A


Përzgjedhja e temperaturës në aparat



G


- Temperaturën e dëshiruar e rregulloni me pullën **A**. Temperaturën e rregulloni në zonën e rregullimit prej **min**. deri në **max**.
 - Rregullimi i rekomanduar i pullës së termostetit është në pozicionin **eco** (resp. -18°C te aparatet me indikatorin digjital).
 - Te aparatet me indikatorin digjital, në kohë të rregullimit të temperaturës ajo rreh dhe tregon temperaturën e rregulluar. Pasiqë rrehja ndërprehet, rregullimi ka përfunduar dhe automatikisht memorohet në memorje.
- Te kyçja e parë, në indikatorin digjital **G** shfaqet temperatura -16°C dhe rreh. Vlera në fjalë shfaqet derisa temperatura në hapësirë nuk ulet nën këtë vlerë. Pastaj, rrehja ndalon, kurse indikator digjital tregon temperaturën faktike në ngrirës.

Ngrirja intensive



- Rregullimin e përdorni te kyçja e parë e aparatit, para pastrimit dhe te futja e sasisë së madhe të artikujve ushqimorë (shiqo »Procesi i ngrirjes«).
- Trusni tastin **E** – ndriçon llambëza **F**. Rregullimi shkyçet automatikisht pas përafërsisht dy ditësh.

Alarmi për temperaturën tejet të lartë në ngrirës




Te temperatura tejet e lartësuar rreh llambëza **D** dhe kyçet alarmi zanor ndërprerës.


Alarmi shkyçet automatikisht, pasi që ngrirësi ftohet mjaftueshëm që nuk ka rrezik për prishjen e artikujve ushqimorë.

- Te kyçja e parë, aparati përban vonesë prej 24 orësh të alarmit të temperaturës, për shkak se ngrirësi nuk arrin temperaturën adekuate. Kështu parandalohet funksionimi i panevojshëm i alarmit.
- Alarmin zanor e shkyçni me tastin **C**.
- Alarmi zanor paraqitet çdo 24 orë, nëqoftëse temperatura në ngrirës nuk është mjaft e ulët dhe ekziston rreziku i prishjes së artikujve ushqimorë.

NJËSIA KOMANDUESE III




NJËSIA KOMANDUESE IV



- A** Pulla e rregullimit të temperaturës, kyçja, shkrycja dhe kyçje e ngrirjes intensive
D Llambëza ndriçon/rreh: sinjali i temperaturës tejte të lartë

Kyçja e aparatit



Pullën e termostetit **A** rrotulloni në drejtim të akrepit të orës kah pjesa më e trashë e signacionit.

Njësia komanduese III:


Te kyçja e parë ndriçon llambëza **D** dhe shuhet vetë, pasi që ngrirësi ftohet mjaftueshëm, që nuk ka rrezik për prishjen e artikujve ushqimorë.

Njësia komanduese IV:


Te kyçja e parë, aparati ka vonesë 24 orëshe të alarmit të temperaturës, pasi që aparati akoma nuk arrin temperaturën e nevojshme.

Kështu parandalohet funksionimi i panevojshëm i alarmit.

Shkrycja e aparatit




Zgjedhja e temperaturës në aparat



Pullën **A** rrotullojeni prapas ashtu, që pozicioni i shigjetës të jetë tek shenja  (aparati është akoma nën tension elektrik).


- Rregullimi i preferuar i pullës së termostetit **A** është në mes të pjesës më të hollë dhe më të trashë të signacionit.
- Ndryshimi i temperaturës së rrethit ndikon në temperaturën në aparat. Kësaj nevojitet t'i adaptohet rregullimi i pullës së termostetit.
Pozicionet kah pjesa më e trashë e signacionit domethënë temperaturën më të ulët në aparat (më ftohtë), kurse pozicionet kah pjesa më e hollë e signacionit temperaturë më të lartë (më ngrohtë).



- Llambëza **D** ndriçon / rreh, kur brendësia e ngrirësit tejtingrohet dhe shuhet vetë, kur ngrirësi ftohet mjaftueshëm, që nuk ka rrezik për prishjen e artikujve ushqimorë (shiqo kaptinën Evitimi i pengesave).


Ngrirja dhe ruajtja e artikujve ushqimorë

Proçesi i ngrirjes



 **Sasia maksimale e artikujve ushqimorë të freskët të cilat mund t'i futni në aparat është e cekur në etiketën me të dhënat elementare për aparat. Nëqoftëse sasia është tejet e madhe, cilësia e ngrirjes është e dobët, dobësohet edhe cilësia e artikujve ushqimorë të ngrirë.**

- 24 orë para ngrirjes së artikujve ushqimorë të freskët e aktivizoni ngrirjen intensive:
 - **njësia komanduese I dhe II:** trusni tastin **E** (ndriçon llambëza **F**),
 - **njësia komanduese III dhe IV:** rrotullojeni pullën **A** në pozicion  (ngrirja intensive).



Vërejtje të rëndësishme për ngrirjen e artikujve ushqimor të freskët

Ruajtja e artikujve ushqimor të ngrirë industrialisht

Pas kësaj kohe, futni artikujt ushqimorë të freskët në hapësirën për ngrirje. Artikujt ushqimorë të freskët le të mos fërkoen me qeskat e ngrira!

- Për ngrirjen e sasive të vogla (1-2 kg), rregullimi i ngrirjes intensive nuk është i nevojshëm.
- Pas 24 orësh, artikujt ushqimorë mund të transferoni në hapësirat tjera të ngrirësit dhe sipas nevojës të përsëritni procesin e ngrirjes.
- Pas përfundimit të ngrirjes, rrotullojeni përsëri pullën **A** në rregullimin e dëshiruar (**njësia komanduese III dhe IV**).
- Në rast se rregullimin nuk e shkyçni me dorë, ai shkyçet automatikisht pas përafërsisht dy dytëve. Temperatura e pjesës për ngrirje rikthehet në vlerën e rregulluar më së fundi (pozicioni i pullës mbetet në *).
- Te ngrirësi NO FROST mund të ngrini në të gjithë sirtarët, por jo më shumë se 7 kg në hapësirën e veçantë, resp. 4 kg në sirtarin e poshtëm.
- Nëqoftëse dëshironi të shfrytëzoni tërë hapësirën shfrytëzuese në ngrirës, mund të evitoni sirtarët dhe mbështjellëset t'i paloni në raft.

⚠ **Në frigorifer ngrini vetëm artikuj ushqimor, të cilët janë të përshtatshëm për ate. Gjithmonë le të jenë cilësore dhe të freskëta.**

⚠ **Zjidhni ambalazhin përkatës artikullit ushqimor dhe ambalazhojeni me rregullsi.**

⚠ **Ambalazha të mos lëshojë lagështi dhe ajër, që artikujt ushqimor të mos thahen dhe të mos humbin vitamina.**

⚠ **Artikujt ushqimor të ambalazhuar shënoni me të dhënat për llojin, sasinë dhe datën e ngrirjes.**

⚠ **Është e rëndësishme, që artikujt ushqimor të ngrijnë sa më shpejt, prandaj mbështjellëset le të jenë të vogla. Para ngrirjes, artikujt ushqimor ftohni.**

- Gjatë ruajtjes dhe përdorimi të artikujve ushqimor të ngrirë, respektoni udhëzimet e prodhuesit. Në ambalazh janë të shënuara temperatura dhe afati i ruajtjes.
- Zgjidhni artikuj ushqimor me ambalazh të padëmtuar, të ruajtura nëpër frigoriferë në temperaturë -18°C ose më të ulët.
- Mos bleni artikuj ushqimor me ngricë, sepse, ata kanë qenë shumëherë të shkrija dhe të ngrira përsëri dhe cilësia e tyre është e dobët.
- Gjatë transportit siguroni artikujt ushqimor nga shkrija. Ngritja e temperaturës e shkurton kohën e ruajtjes dhe e zvogëlon cilësinë e tyre.

Koha e ruajtjes së artikujve ushqimor të ngrirë

Koha e preferuar e ruajtjes në frigorifer

Artikulli ushqimor	Koha
pemë, mish lope	prej 10 deri 12 muaj
perime, mish viçi, shpendia	prej 8 deri 10 muaj
egërsira	prej 6 deri 8 muaj
mish derri	prej 4 deri 6 muaj
mish i prerë	4 muaj
buka, ëmbëlsira, ushqimet e gatshme, peshku	3 muaj
imtësirat	2 muaj
suxhuk i tymosur, peshk i yndyrshëm	1 muaj

Shkrirja e artikujve ushqimor të ngrirë

Me ngrirjen e artikujve ushqimor mikroorganizmat nuk zhduken. Pas shkrirjes, ata në mënyrë të përsheptuar aktivizohen dhe shpejtë e prishin artikullin ushqimor. Prandaj, artikujt ushqimor përsëri të shkrirë përdorni sa më parë.

Shkrirja e pjesëshme e ul vlerën ushqyese të artikullit ushqimor, veçanërisht pemët dhe perimet dhe ushqimet e pregaditura paraprakisht.

Prodhimi i akullit




Enëzës për akull (e përbajnë vetëm disa modele) evitoni kapakun dhe deri në shenjë mbushni me ujë të ftohtë ose ndonjë lëng tjetër, të përshtatshëm për ngrirje. Të mbyllur e vendoni në raftin e ngrirës, me anën e formuar poshtas.

Enëza mundëson prodhimin e 8 katrorëve të akullit.

Rekomandojmë prodhimin e akullit në rezervë.

Katrorët i nxjerrni nga ena ashtu, që ate e mbiderdhni me ujë të ftohtë, e tundeni, hapni kapakëzën dhe i derdhni prej enëzës.

Akumuluesi i ftohjes (e kanë vetëm disa modele)




Në rast të dështimit të energjisë elektrike, akumuluesit e ngricës ngadalsojnë ngrohjen e artikujve ushqimorë të ngrirë. Më shumë efikas janë nëqoftëse i transferoni drejtpërdrejt në artikujt ushqimorë të ngrirë, para, në hapësirën e epër ngrirëse.

- Ngrirësin e shkrihi prej 2 deri në 3 herë në vit, respektivisht më shpesh te hapja e shpeshtë e aparatit. Me transferimin e akumuluesve të ftohjes (e kanë vetëm disa modele) drejtpërdrejtë në artikujt ushqimorë të ngrirë në hapësirën e epër ngrirëse, mund të ulni numrin e shkrijeve të nevojshme.
- 24 orë para shkrijes e aktivizoni ngrirjen intensive që artikujt ushqimorë të ftohen shtesë (shiqoni »Procesi i ngrirjes«).

Pas kësaj kohe nxirni artikujt ushqimor të ngrirë nga frigoriferi dhe siguronit ata që të mos shkrihen.

Shkrirja e ngrirësit



- Shkryeni aparatit – rrotullojeni pullën e termostatit **A** në pozicionin  dhe nxjerrni kabllonë kyçëse nga priza.
- Nxjerrni ollukun shkarkues në fund të frigoriferit dhe vendosni një enë, në të cilën do të rrjedhë uji i shkrië.
- Aparati nuk shkrihet me pajime elektrike (terësi për flokë dhe të ngjashme).
- Gjatë shkrijes mos përdorni sprucues për shkrije, sepse mund ti shkrijnë pjesët plastike respektivisht e dëmtojnë shëndetin.
- Brendësinë e aparatit pastrojeni dhe terjeni (shiqo Pastrimi i aparatit).
- Para se ti futni artikujt ushqimor në frigorifer, kyçni aparatit dhe rrotullojeni pullën **A** prapë në rregullimin e dëshiruar.
- Shkrirja e ngrirësit NO FROST është automatike. Paraqitja e ngricës kohë pas kohe zhduket automatikisht.

Shkrirja e ngrirësit NO FROST

Para pastrimit shkyçeni aparatin nga rrjeti elektrik -

rrotulojeni pullën e termostatit **A** në pozicionin  dhe nxjerrni kabllonë kyçëse nga priza.

- Për pastrimin e të gjitha sipërfaqeve përdorni **leckë të thatë**. Lëndët pastruese, që përmbajnë **lëndë abrazive, acide ose tretësira, nuk janë të përshtatshme**, sepse e dëmtojnë sipërfaqen!

Pjesën e jashtme të aparatit pastrojeni me ujë respektivisht me tretësirë të holluar të detergjentit.


Sipërfaqet e lustruara dhe ata nga alumini mund ti pastroni me ujë të vokët, të cilit i keni shtuar lëndë pastruese të holluar. Lejohet përdorimi i lëndëve pastruese me përmbajtje të ulët të alkoolit (psh. Lëndë për pastrimin e xhamit).

Për materialet plastike përdorimi i lëndëve pastruese, të cilat përmbajnë alkool, nuk është e lejuar.

Pjesën e brendëshme të aparatit pastrojeni me ujë të vokët, të cilit mund ti shtoni pak uthull.

- Shtresat me ngricë ose me akull me trashësi prej 3-5 mm rritin shpenzimin e energjisë elektrike prandaj, ata nevojitet që të evitohen me rregull (nuk vlen për ngrirësin NO FROST). Mos përdorni sende të mprehta, tretës dhe spruces.

- **Kondensatori** në murinë e pasme duhet të jetë gjithmonë i pastër, pa pluhër ose pa mbeturina nga tymi i kuzhinës. Me furçë jometalike të butë ose me aspirator kohpaskohe pastrojeni pluhurin.
- Pas pastrimit, kyçni aparatin dhe futni artikujt ushqimor.



Evitimi i pengesave

Pengesa:	Shkaku repsektivisht evitimi:
Aparati pas kycjes në rrejetin elektrik nuk punon:	Vërtetoni, se a ka tension në prizë, dhe se a është i kyçur aparati.
Sistemi ftohës punon për një kohë të gjatë pandërprerë:	- Temperaturë tepër e lartë e rrethit. - Hapja e derës shumë shpesh respektivisht dera e hapur për një kohë të gjatë. - Dera e mbyllur në mënyrë jo të duhur (ndonjë send në mes dyerve, dera e varur, kontrolli i guarnicionit, dhe kështu me rradhë). - Është futur sasi tejet e madhe e artikujve ushqimor të freskët. - Ftohje e pamjaftueshme e kompresorit dhe kondensatorit. Kontrolllojeni qarkullimin e ajrit pas aparatit dhe pastrojeni kondensatorin.
Tubimi i akullit në brendësi të Ngrirësit është pasojë e:	- Puthitjes së dobët të derës. Nëqoftëse guarnicioni është i ndotur ose i dëmtuar, atë pastrojeni, respektivisht ndërojeni. - Hapjes së shpeshtë të derës respektivisht të derës së hapur gjat kohë. - Futja e ushqimit të ngrohtë në ngrirës.
Ndriçon / rreh llambëza D :	- Hapja e shpeshtë e derës respektivisht dera gjat kohë e hapur. - Dera jo e mbyllur mirë (ndoshta ndonjë gjësend ndërmjet të derës, dera e varur, guarnicioni i dëmtuar,...). - Gjatë kohë nuk ka pasë energji elektrike. - Futur sasia e lartë e artikujve ushqimorë.
Hapja e vështirësuar e derës:	Nëse dëshironi që derën posa të mbyllur përsëri t'a hapni, gjatë kësaj mund të keni vështirësi. Tek hapja e derës, ca ajër të ftohët del nga aparati, atë e zëvendësoni ajri i ngrohtë nga rrethi. Gjatë ftohjes së atij ajri formohet nënshtypje, që është shkak për hapjen e vështirësuar të derës. Pas disa minutave, gjendja normalizohet dhe derën mund ta hapni pa vështirësi.
Ndërimi i llambës (e përbajnë vetëm disa modele):	 - Para ndërimt të llambës patjetër ndërpreni furnizimin me energji elektrike aparatit (nxjermi kabllonë kyçëse prej prize). Evitoheni kapakëzën, ndëroni llambëzën me te re (E 14, me fuqi të njejtë siç është e instaluar ajo fabrikisht) dhe vendoseni kapakëzën në vend të vetë. - Llambëzën e djegur mos e hudhni ndërmjet të mbeturirave organike. - Llambëza është material harxhues dhe garanca e ynë për te nuk vlen! - Llambat që janë përdorur në këtë aparat, janë llamba të posaçme, të dedikuara vetëm për përdorim në aparatet e amvisërisë. Këto llamba nuk janë të përshtatshme për ndriçimin e hapësirave banesore ose në amvisëri.
Llambëza B rreh:	Në rast se rreh llambëza B, thirrni serviserin.

Pengesë:	Shkaku repsektivisht evitimi:
Dukuri e shushurimës së ujit pas mbylljes së derës:	• Pas mbylljes së derës, mund të vijë deri te zhurma e shushurimës. Kjo dukuri është normale dhe shkaktohet për shkak të barazimit të shtypjeve.
Shfaqja e kodës së gabimit në indikator (e kanë vetëm disa modele):	• Nëqoftëse në indikator shfaqet E, thirrni serviserin.

Nëse asnjëri nga shkaqet e lartëpërmendura nuk përputhet, thirrni servisesin më të afërt të autorizuar dhe përmendni tipin, modelin dhe numrin serial me etiketën me të dhënat elementare të aparatit, e cila është në brendësinë e aparatit.

Ftohjen në aparatet ftohës-ngrirës e mundëson sistemi ftohës me kompresor (tek disa aparate edhe ventilator), ajo pra shkakton zhurmë të caktuar. Fuqia e zhurmës varet nga rregullimi, përdorimi i drejtë dhe vjetërsia e aparatit.

- **Pas nisjes** së aparatit, mundësohet funksionimi i kompresorit (zhburitje e lëngjeve) respektivisht qarkullimi i lëndës ftohëse gjatë funksionimit është më i zëshëm. Ajo nuk është shenjë prishjeje dhe nuk ka ndikim në kohën e jetës së aparatit. Me kohë gjatë funksionimit të aparatit zërimi i atyre zhburitjesh zvogëlohet.
- Disa herë, gjatë funksionimit të aparatit paraqiten edhe **zhburitje të pazakonshme ose më të fuqishme**, të cilat për aparatin janë të pazakonshme dhe në të shumtën e rasteve janë si pasojë e rregullimit joadekuat:
 - Aparati duhet të qëndrojë drejtë dhe stabil në dysheme të fortë.
 - Nuk guxon të preken muritë ose elementet fqinje.
 - Kontrolloni, se a janë pajimet e brendshme në vendin e vetë, respektivisht se a bëjnë rapëllimë konservat, shishet ose enët tjera, sepse ndërmjet veti fërkohen.

FREEZER BASIC



266497

sq (01-14)